

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-023/13

**Prishtinë/Priština
1 tetor 2013**

Në çështjen juridike të:

A.G

*Pala ankuese
(pala e interesuar)*

kundër

M.B

Paraqitësi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/126/2011 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 90976), të datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 1 tetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Pranohet ankesa e A.G e paraqitur me 21 dhjetor 2012 kundër vendimit të KPCC/D/A/126/2011, të datës 26 tetor 2011.
- 2- Anulohet vendimi KPCC/D/A/126/2011, i datës 26 tetor 2011, sa i përket pjesës që ka të bëj me lëndën e regjistruar në AKP me numër KPA 90976, për shkak se është lëshuar marrë në mungesë të kompetencës, dhe refuzohet kërkesa si e palejueshme.
- 3- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë M.B që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro) dhe duhet të paguhet në buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

M.B, me 29 janar 2007 ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (APK), duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 283/1, 394/1, 506/2, 541/2, që gjenden në fshatin Lukac i Begut. Ai ka pretenduar se gjyshi i tij i ndjerë D.B është pronari i pronave në fshatin Lukac i Begut .

Në formularin e kërkesës më tej thuhet se me nënshkrimin e formularit, paraqitësi i kërkesës vërteton se prona private është humbur si rezultat i rrethanave të viteve 98/99 në Kosovë dhe se data e humbjes është 12/06/1999.

Në mbështetje të kërkesës, M.B ka dorëzuar kopjet e certifikatës së vdekjes të D.B, certifikatën e martesës së N.Ć dhe M.B, si dhe fletën poseduese nr. 24, që *inter alia* përshin në fletë edhe ngastrën kadastrale nr. 394/1 në emër të B.R.Đ, të lëshuar nga Administrata Gjeodezike Komunale në Istog/Istok, e datës 24.11.1978 si dhe autorizimin e dhënë atij nga N.B.¹

¹ Mbiemri i paraqitësit të kërkesës si dhe i paraardhësve të tij paraqitet si "B." në përkthimin në Anglisht të kërkesave origjinale ndërsa shfaqet si B. në përkthimin në Anglisht në disa dokumente tjera. Po ashtu, mospërputhja në emrin e mbajtësit të së drejtës në pronës sipas dokumenteve të dorëzuara është D. si dhe në regjistrat kadastral paraqitet si Đ. vërehet si çështje e gabimeve tipografike dhe është konfirmuar nga AKP-ja se që të dy i referohen të njëjtit person (*shiko Shtojcën e Raportit të AKP për procedimin e kërkesave për KKP- në të datës 6 tetor 2011.*

Edhe pse ngastrat kadastrale të pretenduara në formën fillestare të kërkesës nuk ishin afër njëra tjetrës, kërkesa origjinale me numër KPA 17892 është dashtë të ndahet dhe kërkesa sa i përket ngastrës numër 394/1 u regjistrua me numër të ri KPA 90976.

Sipas dokumenteve në lëndën e AKP-së, parcela e sipërcekur është vizituar me 22 prill 2009 shihet dhe theksohet se nuk ishte e zënë. Meqë nuk kishte udhëheqës të fshatit dhe se asnjëri prej fshatarëve nuk pranoi që ta marr shpërndarjen e listës, publikimet u vendosen pronën publike në hyrje dhe dalje të fshatit Llukac i Begut si zgjidhje alternative. Po të njëjtat publikime u vendosen edhe në Komunën e Isogut, në Kadastër, në Gjykatën Komunale, si dhe Zyrën Regjionale të AKP-së në Pejë. Po ashtu, lista dhe Gazeta iu shpërnda Këshilli Norvegjez i Refugjetave-së, OSBE-së, UNHCR, Agjencisë Kosovare të Privatizimit, EULEX-it dhe Avokatit të Popullit. Kjo do të thotë se publikimi i kërkesës u bë përmes publikimit në gazetë mirëpo jo drejtpërdrejt uzurpuesit apo palës së interesuar e cila pretendon/ mund të pretendoj të drejta ligjore në ngastër.

Gjatë gjykimit nga shkalla e parë nuk u dorëzuar asnjë njoftim për pjesëmarrje në procedurë.

Në bazë të verifikimit të certifikatës së martesës, certifikatës së vdekjes, Dokumentit të Identifikimit, si dhe fletës poseduese nr. 24 duke e krahasuar me certifikatën për pronën e paluajtshme UL-708060002-00016, të datës 18/11/2009 e gjendur në regjistrat publik në Departamentin e Kadastrës në Istog/Istok, të kryer AKP, Sekretaria Ekzekutive ia ka referuar rastin KKPK-së së bashku me Raportin për Procedimin e Kërkesës.

Përmes vendimit Gruporë të KPCC/D/A/126/2011, të datës 26 tetor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) ka vendosur që paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar pronësinë e titullarit të ndjerë të së drejtës në pronë mbi ngastrën e kërkuar. Në vendimin e vërtetuar në kuptim të Nenit 8.8 të Shtojcës së Udhëzimit Administrativë (UA) të UNMIK-ut 2007/5, i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ishte vendosur që paraqitësi i kërkesës M.B ka të drejtën e posedimi mbi ngastrën nr. 394/1, si dhe pala përgjegjëse në kërkesë, ose cilido person që e ka uzurpuar pronën urdhërohet që ta liroj atë brenda 30 ditëve prej marrjes së urdhrit.

Vendimi iu dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 28 shkurt 2012, si dhe ai ka kërkuar që prona të vendoset në listën e pronave të administruara nga AKP-ja.

Pala ankuese, si njëra nga palët e interesuara, me 26 dhjetor 2012 e ka pranuar vendimin e atakuar të KKPK-së. Përmes përfaqësuesit të tij B.L, nga Peja, me datë 21 dhjetor 2012 ka paraqitur ankesë.

Pala ankuese në ankesë ka theksuar se babai i tij i ndjerë K.(S)G, më parë nga, e ka blerë pronën në fjalë prej gjyshit të paraqitësit të kërkesës . Ai ka pretenduar se babai i tij ka paguar 4,1000.00 dinar si çmim të shitblerjes në praninë e fqinjëve P.T dhe M.G. Babai i ankuesit më tutje thekson se ai, vëllezërit dhe motrat e tij e kanë mbajtur në posedim pronën në fjalë që nga viti 1974. Për të provuar këtë pretendim ai ka sugjeruar që të dëgjohen dëshmitarët I.G, B.G dhe V.(M) B. Ai po ashtu ka bashkangjitur edhe deklaratën e përbashkët të Sh.R.B, S.M.G dhe A.R.S VR.nr. 2110/12e cila u vërtetua në Gjykatën Komunale në Istog me datë 04 dhjetor 2012. Në këtë deklaratë thuhet se K.G e ka blerë pronën e regjistruar si ngastra kadastrale nr. 394/1, që gjendet në Istog në fshatin Llokavc i Begut në vitin 1974 nga shitësi Xh.B si dhe çmimi është paguar në para të gatshme. Më tej thuhet se blerësi e ka ndërtuar një shtëpi në këtë pronë në vitin 1986 e cila ishte djegur gjatë konfliktit se bashku kontratën e shitblerjes që gjendej në të.

Në ankesën e vet, a ka theksuar se vendimi i atakuar përfshinte gabime të rënda për shkak të mos shfrytëzimit të provave themelore ligjore, zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, shkelje të të drejtave të njeriut gjatë zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 si dhe ligjin në fuqi nr. 03/L-079. Ai ka deklaruar që së bashku me motrat dhe vëllezërit e tij kanë ngritur padi në Gjykatën Komunale duke kërkuar vërtetimin e të drejtës në pronë ndaj ngastrës kadastrale të regjistruar si C.nr. 230/12, për të cilën Gjykata me 7.11. 2012 ka aprovuar masën e përkohshme në favor të paditësve duke ia ndaluar pronarit të tanishëm të regjistruar tjetërsimin e mëtejshëm të pronës në fjalë.

Pala ankuese me tej ka pretenduar se përpjekjet e paraqitësit të ankesës nuk duhet të lejohen duke keqpërdorur të drejtat që vetëm dëshmojnë se pasuria e paluajtshme deri para ca kohësh në të kaluarën ishte e regjistruar në fletën kadastrale pranë Komunës së Istogut në emrin e gjyshit të tij edhe pse ai mirë e ka ditur se gjyshi i tij e ka shitur atë pronë para 40 viteve.

Ai ka theksuar se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e pronës si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999, ashtu siç kërkohet nga Rregullorja e UNMIK-ut për procedurat pranë AKP-së.

Ankesa e A.G ishte dërguar tek paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë me 6 mars 2013. Ai nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës.

Me 22 maj 2013, gjyqtari raportues ka lëshuar urdhrin për paraqitësin e kërkesës/palën përgjegjëse në ankesë duke i dhënë mundësi që të përgjigjet ndaj pretendimeve të palës ankuese për blerjen e pronës në fjalë në vitin 1974 si dhe që të shpjegoj para gjykatës se në cilën mënyrë humbja e pronës

së kërkuar është e lidhur drejtpërdrejt ose rezulton prej konfliktit të armatosur që ka ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 deri me 20 qershor 1999 (sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Me këtë urdhër atij i është rikujtuar se mund ta humbas rastin nëse nuk vepron në përputhje me urdhrin e gjykatës.

Urdhri është dërguar tek pala përgjegjëse në ankesë me 23 maj 2013. As ndaj urdhrin ai nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

1. Statusi i palës ankuese në procedurë dhe pranueshmëria e ankesës

Ankesa është e pranueshme.

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, për zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi.

Pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurat pranë KKPK-së. Kërkesa nuk është kontestuar në shkallën e parë

Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, kërkon që, çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përafërta, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1. Neni i sapo cekur i përcakton mënyrat e njoftimit sikurse njoftimi i çdo personi që mund të ketë interes juridik ose varësisht nga rasti në formë të njoftimit në publikimet zyrtare të Sekretarisë Ekzekutive.

Në anën tjetër, neni 10.3 i të, i njëjtës Rregullore, përcakton përjashtimin se *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdo qoftë gjatë procedurës.*

Paraqitësi i kërkesës për rastin në fjalë nuk ka ofruar ndonjë emër të personit që e ka uzurpuar pronën si dhe njoftimi i kërkesës është bërë me publikim në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së dhe me shpërndarje tek organet e duhura qeveritare. Përshtatshëmrisht, pala ankuese personalisht nuk e

ka pranuar njoftimin për kërkesë. Pala ankuese ka pranuar vetëm vendimin e KKPK-së kundër të cilit edhe ka paraqitur ankesë.

Gjykata Supreme del në përfundim se ai është bërë palë në procedurë sapo është njoftuar për kërkesën përmes ankesës. Megjithatë, ankesa kundër vendimit të KKPK-së është paraqitur brenda afatit kohor siç përcaktohet me nenin 12.1 të Rregullores së lartcekur. Pala ankuese ka interes në këtë kërkesë përderisa pretendon se ai është pronari i pronës së kërkuar. Prandaj, ankesa e tij është e pranueshme.

2. Meritat e ankesës

Ankesa është e bazuar ngase ka të bëj me kërkesën për anulim të vendimit të KKPK-së.

Nga parashtruesat e lëndës rezulton se vet deklarata e palës ankuese si dhe deklarata e përbashkët e Sh.R.B, S.M.G dhe A.R.S, e cila u vërtetua në Gjykatën Komonale në Istog me datë 04.12.2012, i referohen pretendimet se prona e kërkuar i është shitur babait të palës ankuese nga ana e paraardhësit të paraqitësit të kërkesës në vitin 1974. Pala ankuese thekson se ai si dhe familja e tij e kanë poseduar këtë tokë qysh prej vitit 1974. Ai e ka kontestuar pretendimin e paraqitësit të kërkesës ashtu siç shfaqet në formën e nënshkruar të kërkesës, se posedimi është humbur si rezultat ose gjatë konfliktit të armatosur në vitin 1998/1999. Ai më tej iu është referuar edhe lëndës në pritje pranë Gjykatës Komonale për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën në fjalë.

Gjykata Supreme thekson se nuk është relevante për rastin në pritje pranë gjykatës nëse një transaksion i tillë i shitjes së pronës që pretendohet se ka ndodhur në vitin 1974 në mes të paraardhësit të paraqitësit të kërkesës dhe palës ankuese a ekziston dhe/ose është ligjërishit i vlefshëm. Për Gjykatën Supreme në këtë fazë është më rëndësi se a ka apo nuk ka kompetenca për t'i dëgjuar pretendimet e tilla të palës ankuese. Gjykata ndaj kësaj pyetje përgjigjet negativisht ngase çështja nuk është në kompetencë të saj. Kjo çështje duhet diskutuar nga gjykata e rregullt.

Meqë askush nuk ka parashtruar ndonjë njoftim tek Sekretaria Ekzekutive e APK-së në lidhje me qëllimin e tij/saj për të marr pjesë në administrimin e procedurës në shkallën e parë, supozimi i AKP-së dhe KKPK-së për humbjen e posedimit të pronës gjatë ose si rezultat i konfliktit të armatosur mbetet i pa kontestuar Megjithatë, pohimi i paraqitësit të kërkesës në lidhje me humbjen e pronës me 12 qershor 1999 u kontestua me paraqitjen e ankesës. Paraqitësi i kërkesë/pala përgjegjëse në ankesë nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës të pranuar nga ai. Ai nuk i është përgjigjur edhe urdhrin të gjyqtarit raportues me të cilin i është dhënë mundësia që të përgjigjet ndaj

kontratës së pretenduar të shitjes së vitit 1974, e as në lidhje me humbjen e pronës prej konfliktit të armatosur.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë në urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën në prone por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore sipas rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Që të dy kushtet duhet të plotësohen dhe të provohen. Barra e provës bie mbi palën e cila e pretendon faktin. Paraqitësi i kërkesës ka parashtruar fletën poseduese që tregon regjistrimin e tokës në emër të paraardhësit të tij siç u verifikua nga AKP-ja. Megjithatë, ai nuk ka siguruar ndonjë provë për të provuar se humbja e posedimit mbi pronën lidhet ose rezulton nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999.

Prandaj, supozimi i KKKP-së, në një rast të pa kontestuar, se humbja e posedimit mund të rezultojë nga konflikti nuk mund të qëndroj edhe më tej pas kontestimit nga ana e palës ankuese se paraardhësi i paraqitësit të kërkesës e ka humbur posedimin mbi pronën në vitin 1974 sipas kontratës së shitjes. Paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë nuk ka siguruar ndonjë provë si kusht të dytë për sa i përket kompetencës së KKKP-së, përkatësisht Kolegjit të Apelit të APK-së. Mu për këtë vendimi i atakuar nr. KPCC/D/A/126/2011, i datës 26 tetor 2011, duhet të prishet dhe kërkesa të hudhet për shkak të mungesës së juridiksionit

Nga fakti se kërkesa nuk është në kompetencë të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës as të Gjykatës Supreme në këto procedura, rishqyrtimi dhe vlerësimi i ankesës si dhe pretendimeve mbi kontratën e shitjes sa i përket vlefshmërisë së saj janë të panevojshme.

Prandaj, bazuar në të mësipërmen dhe në pajtueshmëri me dispozitën ligjore të nenit 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor

të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/20): 30 €

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga Paraqitësi i kërkesë që ka paraqitur kërkesë të papranueshme. Sipas nenit 45, paragrafi 1 i Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e takës është 90 ditë. Neni 47.3 parashih që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva- Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it